

Qendra kulturore "Multimedia" organizon Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë

"Polip" shndërron Prishtinën në qendër poetësh

Luise Boege nga Gjermania, Agron Tufa nga Shqipëria, Nikola Madzhirov nga Maqedonia, Arben Idrizi nga Kosova e Tomislav Marković nga Serbia janë disa nga poetët që do të marrin pjesë në edicionin e parë të "Polip"

PRISHTINË, 5 TETOR - Katër ditë kryeqyteti kosovar do të jetë nikoqir i poetëve nga vende të ndryshme të botës. "Polip" është emri i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë, i cili do të nisë rrugëtimin më 14 të këtij muaji.

Festivali, i organizuar nga qendra kulturore "Multimedia", në edicionin e parë, do të sjellë poetë nga Shqipëria, Maqedonia, Austria, Kroacia, Gjermania etj.

Drejtoresha artistike e festivalit "Polip", Lucia Zimmermann, e cila është edhe udhëheqëse e "Multimedias", ka dhënë më shumë detaje lidhur me këtë nismë të qendrës që ajo drejton. Fillimisht, Zimmermann, ka zbërthyer emrin me të cilin është pagëzuar festivali. "Mendojmë se polip (polyp apo oktapodi) ka diçka të përbashkët me poetët dhe me poezinë. Sikurse poeti, polipi "punon" me ngjyrë. Ai përdor ngjyrë me qëllim që t'i ngatërrojë grabitqarët dhe t'u ikë sulmeve të tyre. Prandaj, si poeti, polipi është në gjendje të

krijojë diçka fiktive", ka thënë Zimmermann. "Duke e vlerësuar këtë cilësi, e kemi zgjedhur polipin si maskotë të festivalit tonë", ka shtuar ajo.

Por, sipas Zimmermannit, "Polip" nuk do të kufizohet vetëm me lexime të poezisë.

"Kemi edhe një program të posaçëm të koncerteve, të poezive në rrugë, punëtorive të përkthimit dhe të shkrimit të poezisë, diskutime e debate mbi rrjetet e letërsisë, si dhe praktikë përkthimi", ka thënë ajo, duke përmendur në mesin e muzikantëve, emra si Erëmira Çitaku, Agron Xharra, Visar Kuqi dhe Jan Böttcher.

Zimmermann po ashtu ka thënë se "Multimedia" e ka në plan që festivali "Polip" të shndërrohet në tradicional dhe ka shpjeguar qëllimin e organizatorëve.

"Ideja jonë është që poetët e rinj të takohen mes vete, të shprehin talentin e tyre dhe të krijojnë edhe kontakte", ka thënë ajo.

Luise Boege nga Gjermania, Agron Tufa nga Shqipëria, Nikola Madzhirov nga Maqedonia, Arben Idrizi nga Kosova e Tomislav Marković nga Serbia janë disa nga poetët që do të marrin pjesë në edicionin e parë të "Polip".

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë është mbështetur nga Goethe Institut i Beogradit, Robert Bosch Stiftung, Komuna e Prishtinës dhe "The Olof Palme International Center".

